



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkon ekspertë të jashtëm të kualifikuar në mbrojtjen e fëmijëve në mediat audiovizive.

TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, në mes të muajit tetor 2021, do të organizojë Konferencën “Mbrojtja e Fëmijëve në mediat audiovizive” me synimin e krijimit të një hapësire të lirë të shkëmbimit të pikëpamjeve mes ekspertëve dhe njohësve të fushës, për të diskutuar, prezantuar dhe propozuar ide dhe praktika në dobi të përmirësimit të raportimit mbi dhe për fëmijët në mediat audiovizive, si dhe në funksion të përmirësimit dhe amendimit të kuadrit ligjor në fuqi;

Konferenca do të ketë tri boshte kryesore:

-Procesi rregullues në mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive;

-Edukimi mediatik

-Reklamata dhe promovimi me/për fëmijët

Kush mund të aplikojë?

AMA fton për aplikim ekspertë dhe njohës së fushës, pedagogë e studiues të shkencave të komunikimit dhe gazetarisë, aktivistë të shoqërisë civile (kryesisht nga OJF që janë fokusuar tek fëmijët, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të tyre), përfaqësues nga redaksitë e subjekteve audiovizive etj., që të paraqesin projekt-ide për referim.

Detyrat

Eksperti/ekspertët e angazhuar do të punojnë në mënyrë të pavarur, për të realizuar detyrat e mëposhtme:

- 1. Pas shpalljes së propozimeve fituese nga AMA, ekspertët e kualifikuar do të duhet të realizojnë referimet, brenda afatit, i cili do të përcaktohet nga AMA në një fazë të mëvonshme.*

2. *Ekspertët duhet të jenë të gatshëm të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me AMA-n, për të rregulluar procesin e angazhimit dhe kontributit, honorarit për referimin, dorëzimit të referimit etj.*
3. *Eksperti/ekspertët marrin masa që të jenë prezent ditën e zhvillimit të Konferencës për të prezantuar referimin në një tërësi prej seanceve, sipas planifikimit të agjendës që do të hartojnë organizatorët.*

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. *CV ku përfshihen të dhëna të detajuara mbi angazhimin dhe kontributin në fushën e medias dhe mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme.*
2. *Abstraktin për referim që do të prezantohet në Konferencë. Abstrakti do të jetë deri në 350 fjalë, ku propozuesi duhet të përfshijë: titullin e referimit, një përmbledhje të idesë kryesore dhe ideve të tjera që do të trajtojnë, synimin dhe objektivat, shembullin (apo shembujt) që do të referohet, burimet e informacionit etj.*
3. *Kopje të ID*

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga dita e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët dhe periudha e zbatimit të kontratës pas finalizimit të Konferencës.

Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ekspertit

Projektideja për referim 60 pikë

Eksperienca në fushën e medias dhe mbrojtjes së fëmijëve 40 pikë

Propozuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit që parashikon kjo Thirrje, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AMA-s. Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II” nr.15, Tiranë

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 08 Shtator 2021, ora 12:00

(Pas këtij afati AMA nuk do të pranojë propozime).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 13.08.2021